



Në bazë të nenit 4 të Rregullores për mënyrën, kushtet dhe procedurën e dhënies së mjeteve financiare për realizimin e evenimenteve, forumeve, festivaleve, manifestimeve, projekteve dhe aktiviteteve projektuese në fushën e zhvillimit ekonomik lokal nr. 08-10467/1, të datës 25.09.2024, dhe në lidhje me Programin e aktiviteteve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal të Qytetit të Shkupit për vitin 2024 (“Gazeta Zyrtare e Qytetit të Shkupit” nr. 12/24), Qyteti i Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE

për financimin e projekteve për mbështetjen dhe zhvillimin e sipërmarrësisë, inovacionit dhe konkurrencës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e qytetit të Shkupit për vitin 2024

1. LËNDA

1.1. Lënda e Thirrjes publike është financimi i projekteve për mbështetjen dhe zhvillimin e sipërmarrësisë, inovacionit dhe konkurrencës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e qytetit të Shkupit gjatë vitit 2024 për:

- Organizimin e trajnimeve
- Organizimin e evenimenteve
- Fushatat promovuese

2. E DREJTA E PJESËMARRJES

2.1. Të drejtën e pjesëmarrjes në thirrjen publike e kanë të gjitha shoqatat civile, fondacionet, federatat, institucionet, shoqëritë tregtare dhe agjencitë e marketingut, të regjistruara në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me seli në Shkup, në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione dhe Ligjin për shoqëritë tregtare të cilat i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme dhe kanë dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm.

2.2. Përmes thirrjes publike do të ndahen mjete për financimin e projekteve për mbështetjen dhe zhvillimin e sipërmarrësisë, inovacionit dhe konkurrencës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e qytetit të Shkupit për vitin 2024 nga pika 1, në pajtim me Programin e aktiviteteve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal të Qytetit të Shkupit për vitin 2024 (“Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” nr. 12/24).

3. KORRNIZA KOHORE DHE PËRCAKTIMI I MJETEVE

3.1. Mjetet janë siguruar nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2024 në Programin e aktiviteteve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal të Qytetit të Shkupit për vitin 2024 (“Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” nr. 12/24). Shfrytëzimi i mjeteve të ndara do të rregullohet me lidhjen e Kontratës në mes të Qytetit të Shkupit dhe aplikantit i cili i plotëson kriteret sipas Thirrjes Publike.

4. KRITERET THEMELORE

4.1 Kriteret bazë që duhet të plotësojnë aplikantët e interesuar që marrin pjesë në këtë thirrje janë:

- Të jenë të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me seli në Shkup;
- Ti kenë shlyer obligimet ndaj Qytetit të Shkupit (tatimet, taksat komunale) dhe
- Të mos ketë ndalim të pjesëmarrjes në procedurat e thirrjeve publike, dhënies së kontratave të prokurimit publik dhe kontratave të partneritetit publik privat.

5. KRITERET E VEÇANTA PËR ZGJEDHJEN E APLIKANTËVE

5.1. Kriteret e veçanta për përzgjedhjen e aplikantëve parashikohen në Rregulloren për mënyrën, kushtet dhe procedurën e dhënies së mjeteve financiare për realizimin evenimenteve, forumeve, festivaleve, manifestimeve, projekteve dhe aktiviteteve projektuese në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, e cila është të publikuar në ueb faqen e Qytetit të Shkupit.

6. VLERËSIMI I CILËSISË SË PROJEKTEVE

6.1 Vlerësimi i cilësisë së projekteve të aplikantëve të interesuar që plotësojnë kriteret bazë organizative do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara në pikën 5. Vlerësimi i projekteve të propozuara do të bëhet nga një komision i formuar nga Kryetari i Qytetit të Shkupit.

7. DKUMENTACIONI I NEVOJSHËM TË CILIN APLIKANTI DUHET TA DORËZOJË SË BASHKU ME FLETË APLIKIMIN

7.1. Për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve për mbështetjen dhe zhvillimin e sipërmarrësisë, inovacionit dhe konkurrencës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e qytetit të Shkupit për vitin 2024, aplikanti duhet të dorëzojë bashkëngjitjet në vijim:

- Aplikacioni i plotësuar me shkronja të shtypit të alfabetit cirilik, i nënshkruar nga personi kompetent dhe i vërtetuar me vulën e aplikuesit (aplikacioni do të publikohet në ueb faqen e Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk)
- Statusi aktual nga Regjistri Qendror ose Aktvendimi për regjistrimin e personit juridik;
- Deklaratë e nënshkruar për pagesën e obligimeve ndaj qytetit të Shkupit (tatimi, taksa komunale)
- Vërtetim se nuk ka ndalesë për pjesëmarrje në procedurat e thirrjeve publike, dhënies së kontratave të prokurimit publik dhe kontratave të partneritetit publik privat (Regjistri Qendror);
- Projekt propozimi i plotësuar në mënyrë digjitale me shkronja të shtypit të alfabetit cirilik (Formulari i projekt propozimit do të publikohet në ueb faqen e Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk)
- Plani financiar i plotësuar në mënyrë digjitale me shkronja të shtypit të alfabetit cirilik
- Lista e referencës ose dëshmi (kontrata e nënshkruar për të paktën një projekt të realizuar në fushën për të cilën është bërë aplikimi).

8. MËNYRA E REALIZIMIT TË THIRRJES PUBLIKE

8.1. Me qëllim të përcaktimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të përgjithshme për ndarjen e mjeteve financiare për financimin e projekteve për mbështetjen dhe zhvillimin e sipërmarrësisë, inovacionit dhe konkurrencës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e qytetit të Shkupit për Në vitin 2024, Kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komisionin për realizimin me thirrje publike për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve për mbështetjen dhe zhvillimin e sipërmarrësisë, inovacionit dhe konkurrencës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e qytetit të Shkupit për vitin 2024 (Në tekstin vijues: Komisioni).

8.2. Aplikacionet të cilat do të dorëzohen me vonesë, ato të parregullta (të palexueshme) ose të pa kompletuara dhe që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret do të refuzohen nga Komisioni me konkluzion dhe nuk do të shqyrtohen, për këtë gjë Komisioni do të njoftojë aplikantët, aplikimet e të cilëve janë refuzuar.

8.3. Për aplikimet që janë të kompletuara, të dorëzuara në kohë dhe të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret, Komisioni i bën propozim Kryetarit të Qytetit për përzgjedhjen e aplikantit/aplikantëve për ndarjen e burimeve financiare për zbatimin e projektit/projekteve.

8.4. Kryetari i Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit, miraton Aktvendim për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e projekteve.

Vërejtje:

- **Aplikimet me dokumentacion të pakompletuar apo ato të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh!**
- **Bashkëngjitjet e dorëzuara nuk kthehen.**
- **Çdo aplikant mund të paraqesë vetëm një aplikim pas një thirrjeje publike të publikuar.**

9. AFATI I DORËZIMIT TË APLIKIMEVE

9.1. Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 5 ditë nga dita e publikimit të Thirrjes Publike.

9.2. Aplikacioni me gjithë dokumentacionin duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në adresën: Qyteti i Shkupit, Sektori për zhvillim ekonomik lokal, Bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup (me shënimin - Sektori për zhvillim ekonomik lokal - Aplikim për thirrjen publike për financimin e projekteve për mbështetjen dhe zhvillimin e sipëmarrësisë, inovacionit dhe konkurrencës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territorin e qyteti i Shkupit për vitin 2024).

9.3. Aplikantët e thirrjes publike do të njoftohen për rezultatet në afat prej 15 ditëve nga dita e miratimit të Aktvendimit për ndarjen e mjeteve financiare.

9.4. I gjithë dokumentacioni, aplikacioni për mbështetje financiare, formulari-propozimi mund të merren në hapësirat e Qytetit të Shkupit, Sektori për zhvillim ekonomik lokal, baraka nr. 6, çdo ditë pune nga ora 9:00 deri në ora 16:00 si dhe në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk.

9.5. Pyetjet për sqarim mund të bëhen me shkrim ose në trajtë elektronike në Sektorin për zhvillim ekonomik lokal në adresën: Daniela.Krsteska@skopje.gov.mk.

Kontakti: Sektori për zhvillimin ekonomik lokal

Tel: (02) 3297-328

**KRYETARI I
QYTETIT TË SHKUPIT
Danella Arsovska**
